



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.689/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me apelin e Mirushe Sadikaj, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Istog, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Istog, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. 2232/2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më 13.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli i Mirushe Sadikaj, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Istog, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Istog.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Istog, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Istog, në Vendvotimet: 0606c/02R, 0620C/03R, 0622C/01R dhe 0601C/01R.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë e Vendvotimit si në pikën - II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelin me datën 09.11.2017, e parashtruar nga Mirushe Sadikaj, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Istog, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ku pretendon se në vendvotimin 0606c/02R i është marrë vota nga ana e komisionerëve dhe i është dhënë Vlora Vuthaj. Më tej ka cekur edhe emrat e dy dëshmitarëve dhe deklaratat e tyre.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

Apeli është i bazuar.

Paneli gjeti se pretendimet në apel janë të bazuara për faktin se pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, Paneli ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga

Rezultatit. Andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i e urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në vendvotimin e cekur ne pjesën II te dispozitivit te vendimit dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10. 2017.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura Paneli vendosi si ne dispozitiv te vendimit duke u bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësishtë e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze.*

Nga sa u tha me sipër bazuar ne nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.Anr.689/2017 më datën 13.11.2017.

Kryesuesi i Panelit

Rafet Haxhaj

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.

